



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 771 / 8 Prot.

Durrës, më 30.03.2026

VENDIM

Nr. 48, datë 30.03.2026

PËR

**"MIRATIMIN PARAPRAK TË DRAFT BUXHETIT TË VITIT 2026, PËR
UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar; Vendim. Nr. 75, Datë 12.2.2018 "*Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor*"; Udhëzimit të Përbashkët Nr. 20, Datë 20.9.2019 të MASR dhe MFE "*Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor*"; Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 të Ministrisë së Financave "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*"; Urdhrit nr.4, datë 26.01.2024 të Ministrisë së Financave "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*"; Vendimit nr. 54, datë 19.08.2021 të Bordit të Administrimit "*Për miratimin e rregullores financiare të Institucionit*"; të Vendimit nr.3 dhe nr. 4, datë 18.03.2026 të GMS-së dhe materialet bashkëlidhur, si dhe bazuar në sugjerimet e anëtarëve të tij, në mbledhjen e datës 30.03.2026, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të draft buxhetit të vitit 2026, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

